



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes Thirrjes publike, nxjerr:

### **VENDIM**

#### **PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-ve/KLUBEVE SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve/Klubeve Sportive, për financimin publik të programeve/projekteve sipas Thirrjes publike në fushat e aktiviteteve sportive, publikuar më 12.09.2019, themelohet komisioni në përbërje:

- |                            |   |
|----------------------------|---|
| 1. Jakup Gashi, kryesues,  | Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit |
| 2. Kadrie Ajvazi, anëtare, | Drejtoria e Buxhetit dhe Financave      |
| 3. Valon Shabani, anëtar,  | Drejtoria e Buxhetit dhe Financave      |
| 4. Bardhyl Musa, anëtar,   | Shoqëria civile                         |
| 5. Agim Fazliu, anëtar,    | Shoqëria civile                         |

z. Agim Idrizi, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

##### **Neni 2**

Komisioni, detyra dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

##### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Arkivit


**Nr. 02-020/04-0080271/19**  
**Podujevë, 10 tetor 2019**



**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në kërkesë me nr.02-400/04-0083025/19 të datës 23.10.2019 të Njesisë për të Drejtat e Njeriut - NJDNJ në Komunën e Podujevës, nxjerrë,

### **V E N D I M**

#### **I**

Me rastin e hapjes së fushatës një mujore “Tetori – Muaji i mundësive të barabarta për personat me nevoja të veçanta”, n’kuadër të fushatës kundër diskriminimit të shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, lejohen mjete financiare në shumë 100.00€.

#### **II**

Mjetet sipas pikës 1, dedikohen për kompensimin e 10 persona me nevoja të veçanta, nga 10.00€ për secilin, për angazhimin një ditor në administratën komunale, të cilët caktohen nga NJDNJ në koordinim me OJQ Handikos – Podujevë.

#### **III**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere n’kuadër të Drejtorisë së Administratës, dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të OJQ Handikos e cila obligohet që mjetet e cekura t’ua shpërndaj personave të caktuar, dhe të paraqesë raport si dëshmi për shpërndarjen e mjeteve.

#### **IV**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në koordinim me NJDNJ dhe OJQ-në – Handikos, që obligohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e këtij aktivitetit dhe ekzekutimin e kompensimit.

#### **V**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-400/04-0083025/19**  
**Podujevë,**  
**23 tetor 2019**



**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**